



Dalës-Izlazna

Nr. 1-30
Br.

Data 17.03.2023
Datum

OBILIĆ - OBILIĆ



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ

Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.23.02.2023, në orën 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Enver Gashi, Labinot Mirena, Ajshe Haliti Pllana, Sami Ahmeti, Bajram Hashani dhe Nazlije Shala

Të pranishmit tjerë: drejtorët komunal, Festina Preniqi, zyrtare për marrdhënie me publikun, përf.e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Enver Gashi, anëtari më i vjetër i Komitetit i cili pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Draft Kodit Etik për zyrtarët e Komunës së Obiliqit
4. Raporti i Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit për vitin 2022
5. Plani i punës së Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit për vitin 2023
6. Shqyrtimi i kërkesave
7. Të ndryshme

Enver Gashi – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, me ç’rast në pikën të ndryshme e kemi edhe raportin për procesin e Këshillave të fshatrave.

Miratohet unanimisht rendi i ditës i cekur më lartë me 6 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Mungoi: Vlora Mjekiqi Kabashi me arsye.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 6 vota për.

Pika 3 e rendit të ditës

Enver Gashi – Siç e dijmë Draft Kodi Etik ka dalë në shqyrtim publik, i ka kryer të gjitha procedurat dhe tash mbetet e juaja me votue.

Sami Ahmeti – Ne jemi dakord që shqyrtimi i Draft Kodit Etik për zyrtarët e Komunës së Obiliqit të shkoj në Kuvendit komunal dhe atje nëse, kemi ndonjë vërejtje, ose ndonjë shtesë jemi të gatshëm me dhënë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal shqyrtimin dhe aprovimin e Draft Kodit etik për zyrtarët e Komunës së Obiliqit.

Pika 4 e rendit të ditës

Enver Gashi – Ju materialin e keni marrë dhe nëse, keni ndonjë vërejtje në raportin e Kryetarit mund ti paraqitni.

Sami Ahmeti – Jemi dakord dhe shumë mirë që bëhen raporte dhe duhet të bëhen raporte për shpenzim kryesisht të parasë publike. Unë ju kisha lutë që në kuadër të këtij raporti, ose në pikën të ndryshme me bë si kërkesë të veçantë, do të thotë ne kishim kërkuar që të bëhet edhe një raport i punës dhe raport financiar për NPL “Kastrioti”. Mendoj se është një sektor që është i ri dhe do të duhej ta kishim një raport për vitin e parë të punës së tyre. Përndryshe, sa i përket raportit të Kryetarit gjithsesi se jemi dakord të shkoj në seancë të Kuvendit komunal.

Enver Gashi – Është një kërkesë me vend sepse ajo Ndërmarrje është në kuadër të Komunës, por meqë është kohë e shkurtë nuk e di a mund ta përgatitin raportin.

Sami Ahmeti – Mendoj se jemi në fillim të vitit, do të thotë kanë shkue 2 muaj dhe në çdo fund vit bëhen raporte të tilla, por nëse s’mund ta bëjnë për këtë mbledhje atëherë për seancën e ardhshme. Mirëpo, gjithsesi është mirë pasi që është në kuadër të krejtë punës me bë një raport të tillë mundësisht për këtë muaj e nëse, jo mbetet për muajin e ardhshëm.

Pas diskutimeve, anëtarët e Kuvendit komunal me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal raportin e Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit për vitin 2022.

Pika 5 e rendit të ditës

Enver Gashi – Ju, Planin e punës të Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit për vitin 2023, e keni marrë dhe nëse nuk keni diçka me diskutue atëherë e rekomandojmë për seancën e Kuvendit komunal.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal Planin e punës të Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit për vitin 2023.

Pika 6 e rendit të ditës

Enver Gashi – Paraqiti kërkesën nga Fazli Përvetica, për ndërtimin e një objekti për të pritë të pamen në lagjen Koskovik, në Breznicë.

Kjo kërkesë shkon për shqyrtim në DSHPE.

Enver Gashi – Paraqiti kërkesën nga Arbër Behrami, lagjja e Koliqëve të cilët janë kategorikisht kundër shfrytëzimit të kësaj rruge për zhvillime biznese.

Kjo kërkesë shkon për shqyrtim në Drejtorinë për infrastrukturë.

Enver Gashi – Paraqiti kërkesën nga Muhamet Berisha, nga fshati Plemetin të cilit i është djegë baraka dhe kërkon ti ndërtohet shtëpia, ose ti mundësohet pagesa e qirasë.

Kjo kërkesë shkon për shqyrtim në DSHPE.

Enver Gashi – E kemi edhe një kërkesë nga Ministria e planifikimit hapësinor dhe infrastrukturës, janë bërë Udhëzime të reja administrative lidhur me Rregulloren për tarifa, ngarkesa dhe gjoba komunale. Mendoj se është bërë pak tepër sepse qe 2 herë po na ndodhë kjo, por sidoqoftë ne mund të ia rekomandojmë Kuvendit komunal.

Sami Ahmeti - Unë kisha pasë dëshirë me ditë pasi që nuk e kemi këtë material, por nuk është problem sepse ka ndodhë edhe herave tjera që nuk e kemi pasë, por cilat janë dhe cili është Udhëzimi administrativ që është ndërrue dhe zyra ligjore, apo kush merret me këtë punë që nuk e ka vërejtje. Unë e kuptoj që kur bëhen ndryshimet ligjore, nuk ma merrë mendja se i ka ardhë ndonjëherë Udhëzimi me postë zyrtarit, por zyrtarët e kanë obligim me i përcjellë ndryshimet që bëhen në atë fushë. Tash, pa dashtë me bë kritika cilat janë vërejtjet dhe në cilat pika u bë vërejtje sepse 2 herë me u miratue një Rregullore në njëfarë mënyre edhe ne po dalim si të padijshëm.

Enver Gashi – Taksat administrative për leje të ndërtimit dhe rritje të densitetit të përcaktuara me këtë Rregullore nuk janë në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi gjegjësisht me Udhëzimin administrativ nr.02/2018, për taksat administrative, për leje ndërtimi, leje rrënimi, tarifa të rregullimit të infrastrukturës. Drejtoria e urbanizmit është duke i harmonizuar tarifat sipas Udhëzimit Administrativ UA nr.02/2022 për

plotësimin dhe ndryshimin e Udhëzimit Administrativ nr.02/2018, pasi të jepet pëlqimi nga Ministria përkatëse, do ti drejtohem Kuvendit komunal.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës nr.-IV-294, e dt.20.02.2023, raporti për plotësim ndryshim të Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha në Komunën e Obiliqit sipas Ministrive të linjave.

Enver Gashi – Po ashtu, e kemi edhe një kërkesë nga Drejtoria për mbrojtje të mjedisit dhe ambientit nga Ministria ku është kërkuar harmonizimi i Rregullores komunale për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Obiliqit, te dispozitat ndëshkuese që parashohin gjobat mandatore me ligjin e ri për mbeturina nr.08/L-071, neni 49.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës nr.IX/21, e dt.22.02.2023, për harmonizimin e Rregullores Komunale për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Obiliqit.

Enver Gashi – Në fillim të mbledhjes e përmenda se e kemi edhe raportin për procesin e Këshillave të fshatave dhe nëse, nuk keni diçka me diskutue e rekomandojmë për Kuvendin komunal.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal Raportin për procesin e Këshillave të fshatrave.

Pika 7 e rendit të ditës

Sami Ahmeti – E kemi diskutue edhe herave tjera, çështjen e barnatoreve në Obiliq, jo që nuk e dijmë por shumë shpesh na ka ndodhë që kësaj radhe i kam edhe 2 kërkesa të qytetarëve që vërtetë, iu ka ndodhë që pas orës 11, ose 12 të natës, për një barnë qoftë 50 centë iu duhet me shkue në Prishtinë. Ne e dijmë se është ligji që lejon 10 km ka mundësi me qenë barnatoret në mes të njëra tjetrës, do të thotë se munden me shkue në Prishtinë. Duke marrë parasysh se jemi një Komunë, që kemi banorë kogja shumë është mirë me bisedue me një ose 2 barnatore me bë njëfarë rrotacioni që me qenë barnatoret 24 orë të hapura. Ne e dijmë se disa prej këtyre personave që mbajnë barnatore shpeshherë thojnë se nuk kemi llogari për shkak se ka pak punë natën. Mirëpo, në qoftë se arrijmë me ia shpëtue jetën, ose shëndetin qoftë të një personi brenda muajit, besoj se ia vlen dhe është sukses shumë i madh. Prandaj, nëse mbetet vetëm për çështje financiare ne si grup propozojmë që Komuna, ta shqyrtoj mundësinë të ndajë 1 ose 2 paga, në formë të subvencionimit të këtyre bizneseve, ti siguroj për këtë drejtim sepse bëhet fjalë për shëndetin publik. Unë ju kisha lutë shumë me shqyrtue me Drejtoritë dhe me pa mundësinë se çka mund të bëhet dhe në seancën e ardhshme e zgjerojmë këtë temë pa marrë parasysh kushdo le te merrë si iniciativë, vetëm se unë besoj se është shumë e rëndësishme për qytetarët tonë. Kjo, është një prej kërkesave që absolutisht nuk ka të bëjë me politikë në cilin krah apo kënde sepse iu shërben të gjithë qytetarëve.

Enver Gashi – Këtë temë nuk është hera e parë që e bisedojmë sepse unë qe 9 vite, veç jam anëtar i Kuvendit komunal dhe pothuajse çdo vit e kemi diskutue. Arsyeja kryesore është se ne nuk kemi mund me gjetë një formë qysh të kompenzohen ata njerëz. Ata kanë kërkuar kompensim, siguri me ua dërgue një polic aty, që ne nuk e kemi policin për Komunë, për shkolla dhe për objektet tona. Unë personalisht jam për këtë dhe të gjithë jemi, sepse nuk është në rregullë ne i kemi 8 barnatore në Obiliq dhe pas orës 11 të natës, për një barnë 50 centë duhet me shkue në Prishtinë, që nuk është largë 5 minuta, por ato 5 minuta ndoshta janë të vlefshme për një të sëmurë. Ne e kemi trajtuar këtë temë, mirëpo zgjidhje nuk kemi mund me gjetë sepse ligjërisht është problem dhe këtë problem nuk e kemi vetëm ne, por e kanë edhe Komunitat tjera.

Sami Ahmeti – Kërkesa e tyre për siguri më duket absurde sepse siguria është për të gjithë qytetarët dhe nuk besoj se ka Komunë që e vënë në aspektin e sigurisë dhe nuk besoj se ka problem sepse institucionet e sigurisë punojnë 24 orë dhe nuk ka telashe. Mirëpo, kjo është vetëm një arsytim për mos me bë atë. Sipas bisedave që unë vetë i kam bërë me këta, thojnë se nuk kemi llogari me punue dhe derisa s'kemi llogari atëherë unë mendoj pasi që Komuna e Obiliqit, ka një buxhet pak më ekstra se Komunitat tjera, me shqyrtue bazën ligjore. Unë nuk po them me vendosë se edhe ne këto vendime që merren dhe po na kthehen prapa pa marrë parasysh edhe pse jemi opozitë nuk na bëjnë nder kurgjë sepse ne duhet me ngritë çështjen ja këtu është gabimi dhe ta përmirësojmë. Ju lus, edhe një herë me pa bazën ligjore dhe nëse, është e nevojshme po i shkojmë edhe ne Ministrive të ndryshme, që me kërkue këtë pa dashtë me etiketue si kërkesën që e thashë paraprakisht se kjo kërkesë është bërë prej të gjithë kolegëve, pa marrë parasysh se cilit subjekt i takon. Mirëpo, këto barnatore u shërbejnë të gjithë qytetarëve pa dallim.

Labinot Mirena – Edhe unë personalisht e kam ngritë çështjen e barnatores dhe kam biseduar me znj. Shabani, drejtoreshë e shëndetësisë. Prej saj kam marrë një konfirmim se kanë bisedue me barnatorët, me të gjithë dhe tash kanë me pritë me publikue listën se cila barnatore ka me qenë kujdestare, do të thotë nga 1 ditë në javë. Për ata që nuk e respektojnë ligjin, Komuna mundet me marrë masa ndaj tyre, për shembull që nuk e ka respektue kujdestarinë që e ka pasë. Sa i përket asaj që kanë thënë se nuk kemi siguri, është e vërtetë por siguria për të gjithë është e njëjtë si te Komuna, te shkolla, ose te barnatorja. Mendoj se zgjidhja duhet të bëhet patjetër sepse është e nevojshme për secilin qytetarë të Obiliqit.

Mbledhja përfundoi në ora 11:29'

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli

Anëtari më i yjetër i Komitetit


Enver Gashi

